

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“F.V Grirëse dhe Pompa për përmirësimin e stacioneve të pompave të linjës së ujrave të ndotura Golem-ITUN Kavajë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

100,693,189.17 (Njëqind milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e nente presje shtatëmbëdhjetë) Lekë pa tvsh

Burimi i financimit: Buxhet shteti

Afati i pageses është i shtrire në vitet 2024-2025-2026

Argumentimi: Bazuar në preventivin e përlogaritur mbështetur në VKM nr.216 dt.13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës** sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme ku të përfshihet instalimi i grirëseve në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të ndotura:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës, për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MPPT/MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-7C Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- b. NP-11A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
- c. NP-12A Punime të inxhinierisë së mjedisit
- d. NS-4A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- e. NS-8A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-7	Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje	Furnizimi dhe vendosja në vepër e rakorderive në tubacionet e shkarkimeve të ujërave të zeza, etj	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NP-11A	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.	Sistemi Scada, Invertera, Panele Diellore, Shtylla Ndricimi, Gjeneratore, Parango Elektrike, etj...	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Secili ze i preventivit ka impakt mjedisor pasi kemi punime te tilla qe ndikojne ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore, zhurmat, ndotja e ajrit, si dhe mbrojtja e flores dhe faunes te zones ne te cilen ndodhet objekti.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.

NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Punime rifiniture me materiale metalik, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to, etj...	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-8	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	Vendosja në vepër e konstruksioneve metalike të thjeshta, etj...	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, në listëpagesat e (3) tre muajve te fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- b. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- c. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- d. 1 (një) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: diploma universitare, kontrata noteriale e punes e vlefshme, CV, libeza e punes.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar në DST.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur *bazuar*

edhe ne afatin e parashikuar per kryerjen e punimeve ne volumin e punimeve si dhe ne zerat e preventivit.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **stafin mbështetës**, në listëpagesat e (3) tre muajve te fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- b. 1 (një) Inxhinier Gjeoded.
- c. 1 (një) Teknik Ndërtimi.
- d. 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, sipas nenit 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021;
- e. 1 (nje) punonjes i pajisur me çertifikatë per "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) një nga inxhinierat e mësipërm si drejtuesin e punimeve i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: diploma, kontrata e punes e vlefshme, CV, libeza e punes.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Ky kriter eshte vendosur *bazuar edhe ne afatin e parashikuar per kryerjen e punimeve ne volumin e punimeve si dhe ne zerat e preventivit.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, në listëpagesat e (3) tre muajve te fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 2 (dy) punonjës mjeteve të rënda, te pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) nga DPSHTRR, për të cilët duhet të paraqitet kontrate individuale e punës e vlefshme dhe Dëshmi Aftësie Profesionale (e vlefshme).
- b. 2 (dy) shoferë, te pajisur me Certificate Aftësimi Profesional (te vlefshme) nga DPSHTRR, për të cilët duhet të paraqitet kontrate individuale e punës e vlefshme dhe Certificate Aftësimi Profesional (e vlefshme).
- c. 1 (një) Hidraulik te pajisur me Certificate Trajnimi / dëshmi profesionale (të vlefshme), për të cilët duhet të paraqitet kontrate individuale e punës e vlefshme dhe Certificate Trajnimi / dëshmi profesionale (të vlefshme).
- d. 1 (një) Saldator te pajisur me Certificate Trajnimi / dëshmi profesionale (të vlefshme), për të cilët duhet të paraqitet kontrate individuale e punës e vlefshme dhe Certificate Trajnimi / dëshmi profesionale (të vlefshme).
- e. 10 (dhjetë) Punëtorë të thjeshtë.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur *bazuar edhe në afatin e parashikuar për kryerjen e punimeve në volumin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.*

Qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është kryerja e punimeve të kontratës objekt prokurimi në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe nga staf teknik i kualifikuar. Për arritjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar të pajisur me dëshmi profesionale sipas legjisllacionit në fuqi si rezultat i punës që do të realizohet në disa fronte të cilat kërkojnë aftësi teknike dhe profesionale.

Kerkesat e mesiperme janë të mbështetura në zërat e punimeve që janë parashikuara në preventiv si edhe në krijimin e besueshmërisë së AK në zotërimin e kualifikimeve të nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, makinerite apo pajisje të tjera asetë fizike të nevojshme për të zbatuar kontratën ku autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për personelin kryesor që ka në dispozicion OE, **duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës për të krijuar besueshmëri publike nga OE për realizimin me efikasitet dhe efikasitet të kontratës.**

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë çertifikatat e mëposhtme:

- a. Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b. Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- c. Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikimet të kërkuara sa më sipër duhet të plotësohen nga i gjithë grupi i marë së bashku.

Argumentimi: Bazuar në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë kërkuar çertifikata ISO. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 25 persona** në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit të shoqërisë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me kohë të plotë.

Operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, gjatë (3) tre muajve të fundit të shoqërisë.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për (3) tre muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë bazuar në vëllimin e punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve në zbatim të VKM nr.216 dt.13.04.2023, Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Praktikisht: Vëllimi i punimeve në leke: Pagën orare: orë/ditë: ditëpunë/muaj: afatin kohor të punimeve = Nr i punëtorëve.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1.	Instrument Topografik (Stacion Total, GPS)	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	Automjet teknologjik për pastrimin e puseve në stacionet e pompimit, i pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo më pak se 150 bar, prurje jo më pak se 300 litra/minute, e pajisur me pompe vakumi për thithjen e materialeve me kapacitet jo më të vogël se 1000 m ³ /ore, e pajisur me bot për largimin e mbeturinave me kapacitet bartes jo më pak se 7-8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3.	Motopompe për largimin e ujrave të ndotura prurje deri në 3500 litra/minut, dhe presion pune jo më të vogël se 5 bar.	në pronësi ose me qira	Copë 1
4.	Kamion me vinc me kapacitet bartes (20 – 22) Ton pajisur me vinc me krah mbi 11 m dhe kapacitet ngrites mbi 4 ton.	në pronësi ose me qira	Copë 1
5.	Motoarganellë për leshimin e grireseve në stacionet e pompimit me kapacitet ngrites mbi 4 ton.	në pronësi ose me qira	Copë 1
6.	Helmeta sigurie	në pronësi ose me qira	Copë 25
7.	Jeleke fosforeshent	në pronësi ose me qira	Copë 25
8.	Tabela paralajmëuese punimesh	në pronësi ose me qira	Copë 40

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash, duhet të shoqerohet me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jenë të dukshme karakteristikat e kërkuara dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga ofertuesi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për makinëritë e mesipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinëritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mesipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Ky kriter është vendosur bazuar edhe në afatin e parashikuar për kryerjen e punimeve në volumnin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.

2.3.9 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në këtë procedurë të ofertojë grirëset e UN, për të cilat duhet të dorëzojnë: Autorizim Prodhuesi ose distributori me objekt prokurimi, Çertifikate ISO 9001:2015 te furnitorit apo distributorit te autorizuar referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe specifikimeve teknike te projektit. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vërtetoj këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje/autorizim lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar. Për të përmbushur këtë kriter operatorët ekonomike duhet të paraqesin;

- a) *Autorizim Prodhuesi ose distributori me objekt prokurimi.*
- b) *Kontrate paraprake furnizimi me distributorin me objekt prokurimi,*
- c) *Katalogjet teknike të materialeve ne gjuhen Shqipe ose Angleze.*
- d) *Çertifikaten e cilesise dhe origjines se materialeve te furnitorit.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, dokumentet e mësipërme duhet ta paraqesë anëtari i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit furnizim referuar preventivit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Njësia e prokurimit gjatë hartimit të kritereve të vecanta të vlerësimit ka vendosur si kriter autorizimin e prodhuesit ose nga distributori i autorizuar, të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse të ofertojë grirëset që do të instalohen në stacionet e pompimit të ujrave të ndotura në këtë procedurë prokurimi, bazuar ne pikën 1/c të nenit 77 të LPP dhe në nenet 39 dhe 40 te VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, pasi në preventivin e punimeve zërat kryesore janë grirëset që do të instalohen në stacionet e pompimit të ujrave të ndotura. Për këtë arsye si dhe duke u nisur nga pesha specifike e tyre në punimet e parashkuara për tu kryer, AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e mallit që do të përdoret për nga vetë rëndësia që ka instalimi grirëseve cilësore në mirëfunksionimin e stacioneve të pompimit.*

Grirëset që do të instalohen në stacionet e pompimit të ujrave të ndotura janë lehtësisht të gjetshme në treg, ne kete kuader dhe marrja e autorizimit të prodhuesit ose e distributorit të autorizuar është një dokument i cili lëshohet nga prodhuesit apo distributoret që tregëtojnë këto produkte. Kërkesa e ketij dokumenti qe ne kete faze krijon nje lehtesi per Autoritetin Kontraktor, pasi ne kete menyre siguron cilesine, specifikimet teknike te te cilave do te jene lehtesisht te kontrollueshe gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura gjate kualifikimit. Nuk kane qene te pakta rastet ku OE gjate zbatimit te kontrates nuk kane respektuar standartet dhe specifikimet teknike. Nepermjet dorezimit te ketij dokumentacioni qe ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimet qe gjate zbatimit te perdor te njejtat produkte. Per t’u theksuar ne vijim te sa me siper cituam, ky kriter eshte vendosur i tille me qellim verifikimin e permbushjes se specifikimeve teknike te grirëseve që do të instalohen në stacionet e pompimit të ujrave të ndotura nga OE.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ngarkuara ne sistemin e APP-se jane hartuar nga specialistet perkates se teknikes.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***